

Specifikime teknike per proceduren “Blerje paisje akses kontroll per mjetet ne APD”.

Autoriteti Portual Durres me ane të kesaj procedure synon blerjen e pajisjeve per ndertimin e ambjenteve te reja te parkimit si edhe zevendesimin e pajisjeve ekzistuese. Pajisjet duhet te jene kompatibel dhe te integrueshem ne sistemet ekzistues te akses kontrollit bazuar ne teknologjine Skidata software Parking.Logic.

Ne vijim lista me specifikimet teknike te paisjeve:

1. Barriera me krah te ngritshem me gjatësi 5 m	Cope 10
<ul style="list-style-type: none">• Te jene me system hiraulik per kontroll intensiv trafiku dhe me hyrje te gjere.• Cikle pune (Duty cycle) ne 24°C 70% motor run time• Shkalla e mbrojtjes: IP 44• Diapazoni I temperatures se ambientit -20°C ÷ +55°C• Veshja e jashtme e njesise baze te barrieres te jete e trajtuar per mbrojtje ndaj ndryshkut.• Tensioni i punes: 230 Vac (+ 6% -10%) 50 (60) Hz• Gjatesi krahu barriere 5 m .• Tipi I krahut material lidhje e forte alumini (rigid), e perforcuar me profilime.• Koha e hapjes maksimalisht 4.5 sekonda.• Te jete i kompletuar me bordin e komandimit, fotocelula ne kolone• Te kete sistem frenimi te krahut ne fund te uljes me kontrol elektronik per te siguruar ulje te bute.• Te kete sistem ftohje me ventilator te kontrolluar ne menyre automatike (automatic fan), me sensor per monitorimin e temperatures dhe kycjen e vetilatorit.• Te jene te pajisur me Valvula hidraulike të sistemit anti-blokim pës per by-pass (Anti-crush system hydraulic valves).• Te kete ngadalësim mekanik te rregullueshëm.• Te kete kontroll me bllokim hidraulik per pozicionin hapur dhe pozicionin mbyllur.• Te kete cetraline elektronike me tre logjika të ndryshme kontrolli: automatik, gjysëm-automatik dhe parkim (P),• Te jete e pajisur me sistem te lirimit automatik te barrierës per rastet kur mungon energjia.• Te jete e pajisur me hyrje/ input emergjence per te marre komande nga sistem te emergjences , si psh raste zjarri per te bere te mundur hapjen automatike te barrierës.• E pajisur me cift sensoresh Infrared dhe loope kontrolli.• Motorri elektrik monofaze me 2 sense lëvizje.• Konfigurimi ne distance : Te kete mundesi te instalimit te pajisjeve per konfigurim ne distance.• Komunikimi RS485. • Te jete e kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshme te montimit. <p>Garancia 1 vit.</p>	
2. Koloneta (te kontrollit te aksesit)	Cope 6
<p>Kollona e aksesit te mjeteve motorrike do sherbeje per te instaluar elementet e sistemit te kontrollit te aksesit si lexues biletash, lexues barcode, sinjalizues apo ekran per shfaqjen e informacioneve. Kollona duhet te jete e ndertuar per kete qellim me permasa te pershtatshme ne menyre qe te mundesoje shoferin te lexoje biletën apo karten e aksesit pa</p>	

zbritur nga makina. Kollona duhet te jete funksionale dhe te mundesoje nderfaqesimin e elementeve te ndryshem duke ofruar komunikimin dhe ushqimin e nderfaqeve.

Keto kollona do te instalohen ne pjesen e aksesit ne zonat e brendshme te portit

Karakteristika fizike

- Te jete e ndertuar me material alumini, ose inox te pa ndryshkem e te jete i lyer me boje ne menyre qe te duroje temperaturat e larta e te ulta, diellin, dhe lageshtiren.
- Te jete i hapshem ne njerin krah per te asistuar pajisjet e instaluara ne te dhe te mbyllet ne menyre hermetike sipas standardit IP43.
- Te punoje ne temperaturat nga $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+40\text{ }^{\circ}\text{C}$.

CPU dhe nderfaqet e komunikimit.

Kollona duhet te kete nje nderfaqe elektronike e cila te mundesoje nderfaqesimin e pajisjeve qe do te montohen ne kollone. Nderfaqja elektronike duhet te jete e ndertuar mbi bazen e nje qarku logjik me CPU dhe qe funksionon me nje sistem operativ si Windows apo Linux. Kjo skede duhet te kete porte per karte memorie SD, porta USB.

Kollona duhet te kete sinjalizim me LED i cili do te sherbeje per te informuar mbi statusin e te kontrollit te aksesit.

Kollona duhet te jete e ndertuar me module qarqesh logjike në menyre qe te ofroje shtimin e opsioneve ne rast nevojë.

Nderfaqet e hyrje-daljeve te domosdoshme ne kollone jane :

- Nderfaqe rrjeti ethernet 10/100 Mbps
- Nderfaqe USB per lidhjen e moduleve me njera tjetren dhe me opsionet e ndryshme qe mund te shtohen si printer, skaner biletash, barcode reader etj.
- Nderfaqe MicroUSB
- Nderfaqe display LVDS per te lidhur ekranin opsional
- Nderfaqe SD Card
- Nderfaqe per te lidhur nje kamera opsionale
- Nderfaqe per te instaluar opsionin e touch screen.
- Altoparlant
- Nderfaqe komunikimi me Barrieren ne forme seriale RS-485 dhe komande
- Celes per komandim manual te barrieres
- Loop detector me 2 kanale per te dedektuar prezencen e automjetit, drejtimin e kalimit, dhe numurimin e makinave
- Nderfaqe per ushqimin dhe komandimin e opsioneve shtese si : Ndricim sinjalizues qe konturon kollonen per tu dalluar me qarte naten, ndricim per panel informativ/rreklame, citofoni per komunikim me asistencen qendrore, etj.

Skedat duhet te kene drita sinjalizuese per te shfaqur gjendjen e komunikimit dhe ne rast problemesh teknike te ndihmoje ne evidentimin e problemeve.

Ushqimi dhe karakteristika ambjentale

- Tensioni i ushqimit te kolonetes 100-240 V, Max 5A
- Tensioni i ushqimit te skedave logjike, 12/24 V DC.
- Temperatura e punes $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri ne $+40\text{ }^{\circ}\text{C}$, Lageshtia 90%.
- Shkalla e mbrojtjes nga faktoret ambjentale IP43.

Aksesore

Te jete e kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshme te montimit. Kolonetat duhet te furnizohen bashke elementi mbajtes qe betonohet i cili duhet te funksionojë si bazament i kollones. Kolonetat duhet te kete mundesi te montohet e zmontohet lehtesisht nga bazamenti.

Garancia 1 vit

3. Licenca per kolonetat e kontrollit te aksesit.

Cope 6

- License per kolonete kontrolli aksesi sipas kerkeses perkatese per koloneten qe do te ofrohet. License e integrueshme me sistemin ekzistues te sistemit te akses kontrollit te instaluar ne institucionin e APD bazuar ne teknologjine Skidata Parking.Logic.

4. Barriera me tra 3 meter

Cope 3

- Barriera te jete prodhuar nga i njeiti prodhues i kolonetave dhe sistemit te aksesit si dhe te kete nderfaqe komunikimi data me koloneten ne menyre qe sistemi software te komunikojë e menaxhojë barrieren.
- Kjo barriere duhet te kete mundesine per te instaluar ne trupin e saj, ne lartesine e traut, nje semafor LED, RGB i cili do te sherbejë per te njoftuar perdoruesit e parkimit te cilet kerkojnë te hyjne ne parking.
- Tensioni i punes: 100-240 V \pm 10% / 50-60 Hz / rreth 500 W
- Temperatura e punes: -20 °C to 50 °C
- Trupi i barrieres, te jete i ndertuar me materiale te forta e te pa-ndryshkshme. Te kete mbrojtje ambientale me standard IP44.
- Barriera te kete mundesi te hapet e mbyllet me shpejtesi dhe kjo shpejtesi te jete e konfigurueshme nga software i sistemit te parking.
- Barriera duhet te kete opsionin e shtimit te nje semafor te instaluar ne trupin e barrieres, me led me 3 ngjyra RGB, e cila duke u ndricuar me ngjyra te ndryshme dhe te konfigurueshme, informon drejtuesin e mjetit ne menyre inteligjente mbi kalimin ne barriere. Keto opsione te jene te personalizueshme nga software i sistemit te parking.
- Trau i barrieres te jete i ndertuar me material te lehte por durues i kushteve atmosferike si dhe ne rast goditje me automjetin, te rrezohet ne toke per te mos demtuar automjetin.
- Ne rastet e goditjes se traut te barrieres, trau te kete mundesine qe pas rrezimit ne toke te rivendoset serish ne barrier.
- Krahu i barrieres te kete gjatesine 3m.

- Krahu i barrieres te mund te komandohet nga nje elektromotorr dhe te mos jete i ndertuar me pajisje hidraulike te cilat kane nevojte per asistence. Te jete pajisje e qendrushme dhe koha e llogaritur ndermjet mirembajtjeve (e deklaruar nga prodhuesi) te jete rreth 1.5 deri ne 2 milion cikle.
- Shpejtesia e hapjes se barrieres te jete e konfigurueshme nga software i sistemit te parking.
- Te kete dedektor te demtimit apo mungeses se traute.
- Barriera duhet te komunikojte ne kohe reale me software e sistemit te parking, duke treguar statusin e saj, si psh Hapur, Mbyllur, offline, etj, si dhe te mund te meren informacione mbi problematiken e barrieres ne kohe reale.
- Barriera te kete mundesi shtese te mevonshme ne rast nevojte te:
 - Te kete aftesi te mbaje krahe te gjate deri ne 4,5m.
 - Te kete mundesi opsionale te montimit ne nje moment te dyte te nje krahe te ndricuar me drita RGB, te cilat ndizen me ngjyra te ndryshme sipas levizjes se krahut te barrieres. Ky opsion duhet te jete i konfigurueshem nga software.
 - Ndricim i konturuar me LED perreth barrieres per te dalluar me qarte barrieren naten.
 - Mundesi instalimi i nje kamere ne trupin e barrieres.

Garancia 1 vit

5. Module per integrim te barrierave me kolonetat Skidata model Lite.Gate

Cope 2

- Bord elektronik ku te kete 2 ose me shume dalje I/O per lidhje per nje ose me shume barriera.
- Bordi te jete i integrueshem me kolonetat dhe me barrierat .
- Bordi te kryeje veprim hapje ose mbyllje me komande per barrieren .

Garancia 1 vit

6. Licensa per ambjente te reja parkimi

Cope 3

- Licensa per ndertimin e ambjenteve te reja te parkimit brenda software aktualisht ne perdorim Parking.Logic. Kjo license duhet te mundesoje krijimin e ambjenteve te reja te parkimit qe mund te funksionojne si ambjente te vecanta parkimi me rregulla te vecanta. License e integruesheme me sistemin ekzistues te sistemit te akses kontrollit te instaluar ne institucionin e APD bazuar ne teknologjine Skidata Parking.Logic.

Afati levrimit te paisjeve:

120 dite